



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

# Buletini

Publikim  
dymujor  
Viti XI  
Nr.67  
Korrik - Gusht  
2014

## AKK-ja dhe DEMOS koordinojnë aktivitetet në fushën e pushtetit lokal



## Drejtoritë Komunale të Arsimit të gatshëm për fillimin e vitit ri shkollor

Kolegjiumi përi Arsim i Asociacionit të Komunave të Kosovës mbajti takimin e Drejtoritë Komunal për Arsim në prag të fillimit të vitit të ri shkollor 2014/2015, e ku mori pjesë edhe ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z.Ramë Buja me stafin e tij.



## U mbajt takimi i Kolegjiumit për Buxhet dhe Financa

Vlen të ceket se si rezultat i takimit dhe presionit nga Komunitet, vetëm disa nga ditët nga ky takim i Kolegjiumit, Ministria e Financave në Qarkoren Buxhetore 2015/1 për Komuna rregulloi paragrafin e tretë të Kontekstit për Përgatitjen e buxhetit komunal për vitin 2015, i cili tashmë është “nga të hyrat vetenake nuk lejohet planifikimi për paga dhe mëditje”. Pra AKK-ja arriti që komunave të mos i'u ndalohej planifikimi për projekte kapitale nga të hyrat vetenake.

## AKK-ja dhe GIZ bashkërendojnë aktivitetet në fushën e shërbimeve komunale

Lajme nga Komunitet

## Drejtoritë Komunale të Arsimit të gatshëm për fillimin e vitit ri shkollor



**Kolegji i përi Arsimi i Asociacionit të Komunave të Kosovës mbajti takimin e Drejtorët Komunal për Arsim në prag të fillimit të vitit të ri shkollor 2014/2015, e ku mori pjesë edhe ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z.Ramë Buja me stafin e tij.**

Drejtorët Komunal njoftuan ministrin e Arsimit z.Ramë Buja rreth përgatitjeve të komunave dhe shkollave për fillimin e mbarë të vitit shkollor si në

aspektin teknik të disa objekteve të renovuara apo objekteve të reja shkollore poashtu edhe masave të ndërmara për furnizimin e nxënësve me tekste shkollore.

Ministri Buja më këtë rast njoftoi Drejtorët Komunal të Arsimit për përgatitjet e duhura të MASHT-it të ndërmara për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor 2014/2015. Ministri Buja me këtë rast falenderoj Drejtorët Komunal të Arsimit për angazhimin dhe bashkëpunimin e ngushtë mes nivelit lokal dhe atij qendror me

qëllim të avancimit të cilësisë së arsimit në Kosovë.

Drejtorët komunal të Arsimit në anën tjetër shprehën gjithashtu edhe nevojën e avancimit të kornizës ligjore sa i përket rolit të drejtorëve të shkollave, kontratës kolektive që kërkojnë sqarime më të e qarta në udhëzimet administrative dhe aktet ligjore.

Drejtorët Komunal të Arsimit u njoftuan edhe me kalendarin e vitit të ri shkollor, ku nga ata u kërkuar një përkushtim edhe më i madh në mbarëvajtjen e procesit të organizimit të testit të maturës shtetërore për nxënësit e mbetur për afatin e dytë.

Në këtë takim të Kolegji i Drejtorëve Komunal të Arsimit u prezentua edhe Programi i organizatës gjermane "ORS" i cili kishte në fokus shëndetin e nxënësve me probleme ortopedike, e ku synon përfshirjen e shumë shkollave në komunat e Kosovës, për identifikimin dhe trajtimin e këtyre dukurive ortopedike prezente tek nxënësit.

## AKK-ja dhe GIZ bashkërendojnë aktivitetet në fushën e shërbimeve komunale

Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Sazan Ibrahim i është takuar sot me Udhëheqësinë e Programit të GIZ "Shërbimet e Qëndrueshme Komunale" z.Kai Hoffmann.

Në këtë takim GIZ ka dhënë mbështetje për AKK-në në përkrahjen e implementimit të Strategjisë së AKK-së për Shërbime Publike.



Poashtu në këtë takim përfaqësuesit e AKK-së dhe GIZ-it janë

pajtuar për implementimin e programit të shkëmbimit të praktikave të mira inovative të zhvilluara në një komunë dhe bartja e tyre në komunat tjera. Përfaqësuesitë e GIZ-it dhe të AKK-së në këtë takim janë pajtuar edhe për thellimin e bashkëpunimit në fushën e shërbimeve publike me theks në fushën e mbeturinave dhe ujit.



## AKK-ja dhe DEMOS koordinojnë aktivitetet në fushën e pushtetit lokal

Sazan Ibrahim, Drejtori Ekzekutiv i AKK është takuar me z.Norbert Pijls, udhëheqës i Programit në Mbështetje të Decentralizimit dhe Vetëqeverisjes Lokale (DEMOS), program ky i financuar nga Agjencioni Zvicerian për Zhvillim (SDC). Ky program do t'i mbulojë 17 komunat e Republikës së Kosovës dhe do të zgjasë deri me 31 dhjetor 2017. Qëllimi i takimit ishte planifikimi për arritjen e sinergjive konkrete dhe të prekshme në mes AKK-së dhe DEMOS-it.

Si hap i rëndësishëm, i diskutuar në këtë takim, është që të dy palët u dakorduan të fillojnë me planifikim të përbashkët të aktiviteteve në mënyrë që të arrihet:

- Koordinim i mirëfilltë i aktiviteteve (në mënyrë që mos të ketë duplikim të aktiviteteve);
- Bashkëpunimi i ndërsjellë (që të punohet për qëllime të njëjta, por duke përdorur veprime të ndara);
- Veprime të përbashkëta (ku kapacitetet njerëzore dhe financiare janë të përbashkëta).

Të dy organizatat diskutuan edhe rreth aktiviteteve kryesore që do të ndërmerren në pjesën e dytë të vitit 2014.

## Lajme nga Komunat

### Komuna e Vushtrrisë dhe e Mitrovicës promovojnë turizmin rural në Rajonin e Shalës

Përmes financimit nga Bashkimi Evropian, Komuna e Vushtrrisë dhe ajo e Mitrovicës, është promovuar një projekt i Shërbimeve të turizmit rural në Rajonin e Shalës ku është ndërtuar një shteg i gjatë i ecjes dhe ngasjes së biçikletave si dhe janë ndërtuar 6 oda – bujtina. Përveç odave në kuadër të këtij projekti është bërë edhe përrurimi i turbinës së ujit në fshatin Sllakovc të Vushtrrisë, e cila është një shembull i prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtitshme. Në projektin për promovimin e turizmit rural në zonën e Shalës janë investuar mbi 470 mijë Euro, prej nga 90 përqind janë kontribut i Bashkimit Evropian dhe implementuar nga Nisma për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë - IADK në partneritet me Komunën e Mitrovicës dhe Komunës së Vushtrrisë.

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë Bajram Mulaku tha se ky rajon ofron mundësi të mëdha për punësimin në turizëm rural.



“Rajoni i Shalës ofron mundësi të shumta, qoftë për turizëm, qoftë për blegtori apo për zhvillimin ekonomik në forma të ndryshme, pastaj kemi edhe objekte të ndryshme të trashëgimisë kulturore të cilat vlen të ruhen dhe konservohen sikur që është vepruar përmes këtij projekti me mullirin, urat, krojet dhe odat”, vlerësoi Mulaku. Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës Safet Kamberi, tha se Shala nuk është e njohur vetëm për xehe dhe minerale të shumta. “Ky projekt është një nismë e mbarë për zhvillimin në veçanti të turizmit të rajonit të Shalës, ndonëse kur flitet për Shalën gjithëherë ndërlidhet në burimet nëntokësore, por përveç atyre burimeve nëntokësore, kjo zonë ka edhe një aset shumë të rëndësishëm e që është zhvillimi i turizmit dhe i bujqësisë”, tha Safet Kamberi.

## U mbajt takimi i Kolegjiut për Buxhet dhe Financa

Asociacioni i Komunave të Kosovës në përkrahje dhe mbështetje të OSBE-së mbajti takimin e radhës të Kolegjiut të Drejtorëve për Buxhet dhe Financa me qëllim të diskutimit të implikimeve buxhetore me theks të veçantë në rritjen e fundit të pagave nga Qeveria e Kosovës, ndikimi i regjistrimit të fundit të popullatës në buxhetet komunale si dhe shkurtimin prej 15% në kategorinë mallra dhe shërbime.

Në takim edhe një herë u shpreh shqetësimi për pasojat e mundshme dhe ndikimit negativ në aktivitetet e përditshme të punës në komuna.

Edhe pse u konsiderua se duhet të ketë konsulta të vazhdueshme me komunat sa i përket vendimeve të Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Financave të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në fushën e financave lokale Kolegjiu nxori disa rekomandime:

- Të shkurtohen procedurat burokratike raport komunë / Ministri e Financave, të mundësohet raportimi elektronik, duke u bazuar në ligj përkatës;
- Pa vendimin ekzekutiv të gjykatave, Thesari të mos të bëjë ekzekutimin e faturave nga borxhet e trashëguara;
- Qeveria duhet të merr përsipër shlyerjen e borxheve nga vitet paraprake dhe mbulimin e shpenzimeve të rritjes së pagave prej 25 %, për nivelin lokal;
- Në Qarkoren Buxhetore



### REZULTATI I TAKIMIT:

**Vlen të ceket se si rezultat i takimit dhe presionit nga Komunitet, vetëm disa nga ditë nga ky takim i Kolegjiut, Ministria e Financave në Qarkoren Buxhetore 2015/1 për Komuna rregulloi paragrafin e tretë të Kontekstit për Përgatitjen e buxhetit komunal për vitin 2015, i cili tashmë është “nga të hyrat vetenake nuk lejohet planifikimi për paga dhe mëditje”. Pra AKK-ja arriti që komunave të mos i’u ndalohet planifikimi për projekte kapitale nga të hyrat vetenake.**

2015/1 për Komuna të qartësohet ose rregullohet paragrafi i tretë të Kontekstit për Përgatitjen e buxhetit komunal për vitin 2015, “nga të hyrat vetenake nuk lejohet planifikimi për paga dhe mëditje dhe kapitale”, kjo kapitale duhet të fshihet **\*(dhe disa ditë pas këtij takimi, Ministria e Financave lejojnë komunat që të planifikojnë projekte kapitale edhe nga të hyrat vetenake);**

- Në bazë të rrethanave politike aktuale, rishikimi i buxhetit 2014, mund të mos aprovohet, për arsye se afati i fundit për shpallje të tenderëve është 31 tetori;
- Përveç rekomandimeve të publikuara nga raporti i DEMOS-it dhe AKK-së, u propozuan edhe rekomandime tjera shtesë të cilat do të përcillen me shkrim tek autoritetet përkatëse.

## Lajme nga Komunitat



### Gjakova prezentohet në konkursin ndërkombëtar të arkitektëve

Kryetarja e Komunës, Mimoza Kusari Lila, ka nënshkruar memorandumun e mirëkuptimit me z.Illir Gjinollin, kryetarin e organizatës "Europan" për prezentimin e Gjakovës në konkursin ndërkombëtar të arkitektëve që hapet në muajin shkurt të vitit 2015, dhe mbetet e hapur për katër muaj. "Kjo nismë ka qenë ide dhe iniciativë e domosdoshme e zgjidhjeve urbanistike të pjesës së vjetër si dhe pjesës së re të qytetit pra do të bëhet përfshirja përgjatë lumit Krena, nga "Ura e Islam Begut" deri te "Ura e Pazarit". "Ky projekt është i rëndësishëm për Komunën sepse rritet funksionaliteti i hapësirës, dhe se si projekt zhvillimor është edhe nxitje për partneritet publiko-privat si dhe atë privat, sidomos në 'Çarshinë e Madhe' " ka pohuar kryetarja Mimoza Kusari Lila.

Në muajin nëntor të vitit 2015 do të shpallen rezultatet e konkursit si projekt ideor, ku marrin pjesë përfaqësues prej mëse njëzet shteteve dhe se e rëndësishme për Komunën është edhe prezentimi i qytetit në një forum evropian dhe njiherit zhvillohet një praktikë e konkurseve të nivelit evropian. Siç është shprehur z.Gjinolli, Gjakova është përzgjedhur për këtë konkurs pasi ka një karakteristikë pasi pjesën e vjetër me atë të renë të qytetit i ndan lumin Krena. Kryetarja Mimoza Kusari Lila duke falënderuar organizatën "Europan" për bashkëpunim ka bërë të ditur se ky projekt do të kushtojë 60 mijë euro.

### Panairi i parë i bujqësisë në Graçanicë

Panairi i parë i bujqësisë është hapur edhe në Graçanicë. Mbi 20 ekspozues prezantuan prodhimet e tyre bujqësore. Panairi u vizitua edhe nga kryetari i Komunës së Graçanicës, Branimir Stojanoviq. Panairi u organizua nga Shoqata "Avenija" nga Llapnasella në kuadër të projektit "Zhvillimi i kooperativave bujqësore dhe rivitalizimi i rajonit". Kryetarja e "Avenisë", Gordana Gjoriq, tha se panairi i parë po mbahet në kushte modeste në mungesë të një hapësire të përshtatshme, por më e rëndësishmja është se iniciativa do të përjetësohet, ajo gjithashtu shpreson se gjatë viteve të ardhshme do të krijohen kushtet më të mira për prodhuesit.

Panairi i bujqësisë në Graçanicë u vizitua edhe nga kryetari i Komunës së Graçanicës, z.Branimir Stojanoviq, i cili tha se komuna do të përpiqet për ta forcuar prodhimin bujqësor. „Bujqësia nuk është mbjellja e grurit dhe misrit dhe kultivimi i frutave. Bujqësia është edhe kultivimi i kërpudhave dhe disa gjërave të tjera. Ne kemi nevojë për ide të reja dhe krijimtari. Ky duket si një hap i vogël, por i rëndësishëm dhe i madh për ne", tha Stojanoviq.

Mirëmbajtja e Panairit të bujqësisë është përkrahur financiarisht nga Komisioni Evropian përmes zyrës së tyre në Kosovë, dhe implementuar nga projekti i Komunës së Graçanicës, në partneritet me YMCA Kosova, Komuna e Lipjanit dhe Komunës së Novobërdës.



## Lajme nga Komunat

### Banka Botërore financon projektin për rindërtimin e kadastrit në pesë fshatra të Drenasit



Komuna e Drenasit është përfituese e projektit për rindërtimin e kadastrit në pesë fshatra, projekt ky i financuar nga Banka Botërore dhe i implementuar nga Agjension Kadastral dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastrë e Komunës së Drenasit. Ky projekt ka për qëllim të ndihmojë zhvillimin e tregut të tokës dhe pronave si dhe të ngritë shkallën e sigurisë mbi pronën e palujtshme.

rore dhe i implementuar nga Agjension Kadastral dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastrë e Komunës së Drenasit. Ky projekt ka për qëllim të ndihmojë zhvillimin e tregut të tokës dhe pronave si dhe të ngritë shkallën e sigurisë mbi pronën e palujtshme.

### KDI vlerëson komunën e Shtimes ndër më të mirat për adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm

Instituti Demo-kratik i Kosovës (KDI) në Prishtinë, ka prezantuar rekomandimet e dhëna për vitin e kaluar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, ku në mesin e komunave që më së shumti ka adresuar rekomandimet e vitit të kaluar ishte Komuna e Shtimes. Sipas këtij vlerësimi të Institutit Demokratik të Kosovës del se Komuna e Shtimes ka implementuar të gjitha rekomandimet e dalura nga raporti i auditorit të jashtëm, me çka dëshmohet se Zyra e Prokurimit që vepron në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është e përgjegjshme dhe zbaton me përpikëmeri Ligjin mbi Prokurimin Publik.

### Mbi 100 biznese i promovuan produktet e tyre në Panairin e organizuar nga Komuna e Gjilanit



Panairi Regjional të produkteve vendore "Gjilani 2014", në të cilin po marrin pjesë shtatë komuna të lindjes, është organizuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e Komunës së Gjilanit dhe i mbështetur nga Bashkimi European, përkatësisht Qendra Regjionale të Marketingut – Lindje.

Në panair po marrin pjesë më shumë se 100 biznese, në mesin të cilave edhe nga minoriteti serb, edhe atë nga Gjilani, Kamenica, Vitia, Ranillugu Novobërda, Parteshi dhe Kllokoti.

Kryetari Lutfi Haziri është shprehur se Gjilani është lider në prodhim, bizneset na bëjnë krenar dhe si të tilla, përmes panairove, mund t'i shohim, t'i prekim shijojmë dhe t'i blejmë këto prodhime që po vazhdojnë me sukses edhe në tregun european dhe atë amerikan.

Ndërsa Drejtori për Zhvillim Ekonomik i Komunës së Gjilanit theksoi se ky panair, me rëndësi të veçantë për regjionin, pretendon të bëhet tradicional dhe në vitin tjetër do të zgjerohet, të kalojë kufijtë dhe të marrin pjesë edhe produktet nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja dhe Gjilanit do t'i krijoj një identitet të ri.

### Pejë: Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur takim të radhës

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i udhëhequr nga kryetari z.Gazmend Muhaxheri ka mbajtur takim të radhës ku janë diskutuar një varg çështjesh me rëndësi për Komunën e Pejës. Komandanti i Stacionit të Policisë në Pejë paraqiti një njoftim nga policia mbi sigurinë në zonën e përgjithësisë për gjashtëmujorin e parë të këtij viti e pastaj u prezantuan disa informata nga përfaqësuesit e disa institucioneve relevante që ndikojnë në siguri si nga Forcat e Sigurisë së Kosovës, Drejtoria Komonale për Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Kulturës dhe EVSB.

## Këshilli i Evropës prezanton tri projekte për komunën e Klinës

Këshilli i Evropës (KiE) në partneritet me Qendrën Rinore "Ardhmëria", kanë zhvilluar një takim në komunën e Klinës, me qëllim që të informohet qeverisja lokale e komunës së Klinës për projektin e përbashkët, "Përkrahje e promovimit të Diversitetit Kulturor në Kosovë, (PDKK), i implementuar nga Këshilli i Evropës në Kosovë. Në këtë takim janë prezantuar tri projekte: Qendra Edukimit për mbrojtjen e Mjedisit dhe biodiversitetit, Mbikëqyrja e Peisazhit (Natyrës) dhe Përformimi i Artit në natyrë të hapur (shpella e Dushit). Këshilli Evropës ka bërë këtë prezantim në mënyrë që të ketë përkrahjen e Komunës për të realizuar këto tri projekte të cilat kanë për qëllim Mbrojtjen e Ambientit, biodiversitetit si dhe aktivitetet rekreative.

Kryetari i komunës, z. Sokol Bashota ka thënë se komuna i përkrah këto projekte, por gjithmonë sipas mundësisë buxhetore që e ka komuna e Klinës.



## Takimi i dytë i Grupit punues për hartimin e Koncept - dokumentit për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën

Grupi punues për hartimin e Koncept-dokumentit për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës Prishtinën, mbajti takimin e dytë me rradhë, konform agjendës legislative të MAPL- së për vitin 2014. Në takim ishte i pranishëm edhe Kryetari i Komunës së Prishtinës z. Shpend Ahmeti, i cili përshendeti punën e Grupit punues dhe shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar përmes përfaqësuesve të saj në këtë Grup punues.

Në fund Grupi u pajtua që pas inpleteve që do merren nga përfaqësuesit e Komunës së Prishtinës, të punohet në një punëtori dhe të ketë një zgjerim të Grupit me akterë të tjerë që kanë impakt në qeverisjen lokale.

## Lajme nga Komunitat



## Ish-deputeti britanik angazhohet për lidhje më të mira të Ferizajt me qytete angleze

Ish-deputeti i palamentit britanik, laburisti John Grogan, gjatë vizitës në komunën e Ferizajt tha se do të përpiqet për të forcuar më tej lidhjet tashmë të krijuara të Ferizajt me qytete angleze si Manchester dhe Oldham.

Gjatë kësaj vizite në komunën e Ferizajt, ish deputeti Grogan, u njoftua nga kryetari Muharrem Sfarça, me vizitën e një delegacioni ferizajas në Angli dhe me lidhjet e krijuara me këtë rast me parlamentarë dhe udhëheqës të Manchesterit e Oldhamit.

Z. Grogan është një ndërmarrës në fushën e minierave, është politikan me përvojë, mik i ish kryeministrit britanik Tony Blair dhe një lobues për të mirën e Kosovës. Ai po viziton disa komuna në Kosovë dhe shpresojmë të na ndihmojë për të krijuar lidhje më të ngushta me qytetet angleze.

Ndërsa ish-deputeti britanik John Grogan tha se ishte në dijeni për vizitën e kreut të Ferizajt në Angli, muajin e kaluar dhe se përpjekjet e tij do të jenë drejt forcimit të lidhjeve tashmë të krijuara me Ferizajn. Ai foli për një komunitet gjithnjë e më të fuqishëm kosovarësh në Angli, i cili po përpiqet për lidhje më të forta ekonomike ndërmjet qyteteve të atjeshme me qytete si Ferizaj.

## Shkurtimisht

- Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga SDC-ja, ku AKK-ja është anëtar në Komitetin Drejtues. Në këtë u prezentua Projektit për Ujë, në vlerë prej 16 milion euro, i cili projekt do të përfshij disa komuna, e ku pjesëmarrja e Qeverisë së Republikës së Kosovës do të jetë me 8 milion euro dhe 8 milion euro nga Qeveria Zvicerane. Ndarja e mjeteve për implementimin e projekteve të ujësjellësit në territorin e Republikës së Kosovës është bërë duke respektuar kriteret e miratuara nga Komiteti Drejtues.
- Përfaqësuesit e Asociacionit të Komunave të Kosovës morën pjesë në Tryezën “Sfidat e Sektorit të Turizmit në Kosovë” organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
- AKK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, do të koordinojë punën për organizimin e trajnimeve për zyrtarët e protokollit të kryetarëve të komunave. Këta zyrtar komunal do të përcjellin Akademinë për Protokol, pa pagesë dhe në fund të Akademisë do të certifikohen.
- AKK-ja është pjesë e takimeve të përbashkëta me nivelin qendror lidhur lidhur me Infrastrukturën Kombëtare Hapësinore, ku është duke u zhvilluar strategjia për këtë infrastrukturë të re në Kosovë e që ka të bëjë me të dhënat gjeohapësinore të Kosovës.
- Projekti i Klimes së Investimeve, i financuar nga SECO, po punon me katër komuna për të bërë inventarizimin e procedurave administrative dhe për të rekomanduar thjeshtimin e tyre aty ku është e mundur. Deri më tani ka përfunduar puna në komunën e Ferizajit e Gjilani, kurse Gjakova është në proces dhe tani po fillohet me Prishtinën. Përfaqësuesit Asociacionit e kanë ndjekur gjithë procesin e punës në Prishtinë.
- Përfaqësuesit e Asociacionit të Komunave të Kosovës morën pjesë në takimin e Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale e Familjare.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

### BULETINI

Viti XI. Nr. 67 • Korrik - Gusht 2014

PËRGATITI:

Arsim Osmani - MENAXHER PËR KOMUNIKIM

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: [info@komunat-ks.net](mailto:info@komunat-ks.net)

Web: [www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacioni i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

